



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 mars 2022
Nr. ref.:RK 1965/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI50/21

Parashtrues

Sevdije Xhaferi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
AC. nr. 5753/2019, të 30 shtatorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sevdije Xhaferi nga Komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) e përfaqësuar nga Ruzhdi Maloku, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [AC. nr. 5753/2019] e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 30 shtatorit 2020 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 31 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 mars 2021, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 2 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 1 prill 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 1 prill 2021, Gjykata i kërkoi informata Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nga parashtruesja e kërkesës.
10. Më 18 nëntor 2021, Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, informoi Gjykatën se fletëkthesa e kërkuar gjendet në Gjykatën e Apelit.

11. Më 20 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit fletëkthesën për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nga parashtruesja e kërkesës.
12. Më 23 prill 2021, Gjykata e Apelit në përgjigjen e saj bashkëngjiti aktgjykimin e saj dhe në komunikim e sipër, theksoi se Gjykata Themelore në Mitrovicë e bënë expedimin e vendimit të palët dhe se Gjykata duhet t'i drejtohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë për fletëkthesën.
13. Më 5 maj 2021, Gjykata përsëri kërkoi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri që të dorëzojë fletëkthesën e kërkuar brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh.
14. Më 17 maj 2021, Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri informoi Gjykatën se dosja e rastit gjendet në Gjykatën e Apelit dhe në mungesë të saj nuk kanë qasje në shkresat e lëndës.
15. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilat ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
17. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KSH50/21, emëroi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi si gjyqtare raportuese në vend të gjyqtares Gresa Caka-Nimani.
18. Më 14 qershor 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të dorëzojë fletëkthesën për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit.
19. Më 17 qershor 2021, parashtruesja e kërkesës njoftoi Gjykatën se nuk ka arritur që ta sigurojë fletëkthesën e kërkuar pasi që dosja e rastit gjendet në Gjykatën e Apelit.
20. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
21. Më 17 korrik 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit që të dorëzojë dosjen e plotë (origjinale) të lëndës.

22. Më 23 korrik 2021, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se dosja e rastit është dërguar në Gjykatën Themelore.
23. Më 26 tetor 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në Gjykatë.
24. Më 1 nëntor 2021, Gjykata informoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës që përkundër shkresave të lartcekura, drejtuar Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, Gjykata Kushtetuese nuk ka arritur të pranojë dosjen në fjalë, dhe nga kjo e fundit kërkoi që t'ia sigurojë Gjykatës Kushtetuese dosjen e plotë të rastit (C. nr. 224/2019).
25. Më 2 nëntor 2021, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit duke përfshirë edhe fletëkthesën.
26. Më 15 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

27. Nga viti 1993, parashtruesja e kërkesës kishte filluar të punoj në Ndërmarrjen "Vushteks". Ndërsa, nga 1 gushti 1999, parashtruesja e kërkesës kishte filluar të punojë në Qendrën për Mjekësi Familjare në Vushtrri.
28. Më 1 gusht 2013, parashtruesja e kërkesës mbushi 20 vite përvojë pune.
29. Më 26 nëntor 2018, parashtruesja e kërkesës paraqiti në Komunën e Vushtrrisë kërkesën për pagesën e dy pagave jubilarë, duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të 11 qershorit 2018.
30. Më 1 mars 2019, Komuna e Vushtrrisë përmes vendimit [Nr. 305] refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se i mungon baza ligjore.
31. Më 27 maj 2019, parashtruesja e kërkesës, kundër të paditurës, Komuna e Vushtrrisë, parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), nëpërmjet të cilës, në emër të shpërblimit jubilar kërkoi pagesën e 2 pagave jubilarë në shumën e përgjithshme prej 835.10 euro, duke u bazuar në nenin 17, paragrafin 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të 11 qershorit 2018.
32. Më 23 shtator 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.224/2019] të 23 shtatorit 2019 aprovoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës dhe detyroi Komunën e Vushtrrisë, që në emër të kompensimit të 2 pagave të shpërblimit jubilar, për përvojën e punës mbi 20 vite, t'ia kompensojë parashtrueses së kërkesës shumën prej 835,10, euro, me kamatë prej 8%, duke llogaritur nga dita e marrjes së vendimit, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën e përgjithshme prej 259 euro.
33. Më 30 shtator 2019, Komuna e Vushtrrisë paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vendimit të lartcekur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të

procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

34. Më 30 shtator 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 5753/2019] aprovoi padinë e Komunës së Vushtrrisë dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për pagesën e dy pagave jubilarë duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të 11 qershorit 2018, me arsyetimin se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është marrë duke konstatuar gabimisht gjendjen faktike në rastin e parashtrueses së kërkesës sepse kjo e fundit: *“20 vjetorin jubilar të përvojës së punës e ka arritur në vitin 2013, në momentin kur kontrata kolektive e sektorit të shëndetësisë nuk ka qenë në fuqi, as kontrata e përgjithshme kolektive ndërsa kontrata e cekur nuk prodhon efekt retroaktiv”*.
35. Më 6 janar 2021, parashtruesja e kërkesës përmes Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit kërkoi të parashtrohet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore.
36. Më 2 shkurt 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KMLC. nr. 2/2021, e refuzoi propozimin e parashtrueses së kërkesës, me arsyetimin se në këtë çështje nuk ka bazë ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
37. Më 24 shkurt 2021, parashtruesja e kërkesës iu drejtua Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit duke kërkuar që të përjashtojë Prokurorin I. S., nga vendosja e rastit të saj, me arsyetimin se: *“I njëjti në këtë rast dy herë me njoftime është duke refuzuar pa kurrfarë arsye paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe pse në propozimet tona kemi ofruar prova konkrete me anë të së cilës rezulton bazueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë”*.
38. Më 26 shkurt 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes Njoftimit [KMLC. nr. 2/2021] iu përgjigj parashtrueses së kërkesës, duke theksuar se: *“Prokurori i shtetit z. Idain Smailji, lidhur me këtë lëndë-rast, të ketë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore adekuate të ligjit për Procedurën Kontestimore, duke konstatuar se në rastin konkret nuk kishte pasur shkelje ligjore që do të mund t'i atribuoheshin aplikimit të gabuar të drejtës materiale, ashtu që kjo konsiderohet si e trajtuar dhe e mbyllur”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së, me arsyetimin se Aktgjykimi [AC. nr. 5753/2019] i Gjykatës së Apelit, i 30 shtatorit 2020 *“karakterizohet nga mungesa e arsyetimit adekuat pasi që arsyetimi juridik të cilin e ka dhënë kjo gjykatë, nënkupton me mohim të padrejtë të së drejtës së parashtrueses për gëzimin e beneficioneve nga neni 17, par.3 pika 3.2 lidhur me par.4 të Kontratës Kolektive Sektoriale e cila është në fuqi nga data 11.06.2018”*.

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në vendimin e saj. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës thekson se: *“Në rastin konkret parashtruesja e kërkesës në momentin kur e ka parashtruar padinë ka pasur 26 vjet përvojë të punës. Sipas nenit 17 pad pika 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e cila ka hyrë në fuqi me 11.06.2018, janë paraparë benificionet lidhur me stazhin e punës, ashtu që për punëtorët shëndetësorë të cilët i kanë mbushur 20 vite të përvojës së punës në institucione shëndetësore, i paguhen dy paga mujore. Pretendimet se paditësja në vitin 2013 i ka mbushur 20 vite të përvojës së punës dhe se në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi kontrata kolektive sektoriale, nuk janë arsye për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, kjo pasi që këto beneficione janë paraparë me rastin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate me datën 11.06.2018, dhe në momentin e ushtrimit të padisë e ka plotësuar kushtin 20 vjeçar për të përfutur këtë shpërblim jubilar ngase e njëjta ka pasur 26 vite përvoja të punës dhe paraqitja e padisë sipas nenit 87 të Ligjit të Punës të Kosovës ka qenë brenda afatit ligjor prej 3 viteve nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës”.*
41. Parashtruesja e kërkesës në mënyrë specifike thekson se Gjykata e Apelit në një rast tjetër, i cili sipas saj ngërthen çështje të njëjta ligjore me ato të rastit të saj përmes Aktgjykimit të saj kishte refuzuar ankesën e Komunës së Vushtrrisë, duke i mundësuar kështu palës realizimin e shpërblimit jubilar. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykata e Apelit, duke vendosur ndryshe dhe duke u mbështetur në dispozita të njëjta ligjore në dy raste të njëjta ka shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
42. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës pohon se: *“Është i çuditshëm fakti se si në rastin e parashtrueses së kërkesës Sevdije Xhaferi, ashtu edhe në rastin e paditëses V. M., dy anëtarë të kolegjit janë të njëjtë që kanë marrë pjesë në të dy rastet, por që lidhur me çështjet juridike të njëjta në kuadër të 2 muajve kanë dhënë mendime dhe kanë nxjerrë vendime të ndryshme”.*
43. Përgjatë pretendimeve të saj, parashtruesja e kërkesës thekson: *“Nëse Gjykata e Apelit të Kosovës me vendimin e saj, shmanget nga praktika e deritanishme e saj, duhet të ofrojë arsye të plota dhe të duhura juridike, lidhur me këtë ndryshim të qëndrimit të saj juridik. Siç ka theksuar edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në praktikën e saj gjyqësore lidhur me mungesën e arsytimit juridik, ekzistimi i dallimeve të thella dhe afatgjate, në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, përfshirë Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, cenojnë drejtpërdrejtë parimin e sigurisë juridike”.*
44. Në mbështetje të pretendimeve të lartcekura, parashtruesja e kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të: (i) Gjykatës në rastet KI55/09, parashtrues N.T.SH Meteorit, Aktgjykimi i 6 prillit 2021; rasti KI97/10, parashtrues Nehat Salihu, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2021; rasti KI135/14, parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i 8 shkurtit 2016; si dhe (ii) Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) rasti Hadjianastassiou kundër Greqisë, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992.

45. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC. nr. 5753/2019] e Gjykatës së Apelit, të 30 shtatorit 2020.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

48. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

49. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC. nr. 5753/2019] e Gjykatës së Apelit, të 30 shtatorit 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
50. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullit (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

51. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj nuk ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për realizmin e shpërblimit jubilar.
52. Thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës është që Gjykata e Apelit nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm Aktgjykimin e saj dhe ka interpretuar gabimisht aplikueshmerinë e Kontratës Kolektive Sektoriale të 11 qershorit 2018, në rrethanat e parashtrueses së kërkesës. Më tutje, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshe në Aktgjykimin [AC. nr. 1902/2020], duke u mbështetur në dispozita të njëjta ligjore megjithëse rastet ishin të njëjta, dhe për pasojë ka shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
53. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka vendosur gabimisht kur nuk ka aplikuar Kontratën Kolektive Sektoriale të 11 qershorit 2018 në rrethanat e parashtrueses së kërkesës, në mënyrë që të realizojë shpërblimin jubilar me përmbushjen e 20 viteve të përvojës së punës.
54. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t’iu tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t’u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37007/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 37; si dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI97/16 parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 46).
55. Gjykata thekson se, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih, gjithashtu, rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61), argumentet kryesore të parashtruesve të kërkesave duhet të adresohen (shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005 dhe *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është një arsye e mirë në ligj nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 (shih rastin e GJEDNJ-së *De Moor kundër Belgjikës*, nr. 16997/90, Aktgjykimi i 23 qershorit 1994 si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 51).

56. Për sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta adresuan pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe në fund, Gjykata e Apelit shpjegon se përse duhet të refuzohet kërkesa e parashtrueses së kërkesës për realizmin e shpërblimit jubilar.
57. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 224/2019] të 23 shtatorit 2019, kishte vendosur të aprovojë kërkesën e parashtrueses së kërkesës për shpërblim jubilar me arsyetimin se: *“Në bazë të provave të analizuara, e bazuar në nenin 17 par 3.2, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e lidhur me datën 11/06/2018, në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se: Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë të: Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të 2 pagave mujore të tij, andaj gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për gjykatën nuk është kontestuese se paditësja ka përvojë pune mbi 20 vite dhe se punëdhënësi i fundit i saj, është e paditura”.*
58. Në vazhdim, Gjykata e Apelit, pas inicimit të ankesës nga Komuna e Vushtrrisë, përmes Aktgjykimit [CA. nr. 5753/2019] të 30 shtatorit 2020 kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për shpërblimin jubilar, duke sqaruar si në vijim:
- “Në rastin konkret paditësja 20 vjetorin jubilar të përvojës së punës e ka arritur në vitin 2013, në momentin kur Kontrata Kolektive e Sektorit të Shëndetësisë nuk ka qenë në fuqi, as Kontrata Përgjithshme Kolektive ndërsa kontrata e cekur nuk prodhon efekt retroaktiv. Nga të gjitha të cekurat rezulton se nuk ka bazë juridike për realizimin e kërkesës së paditëses, dhe se e paditura nuk ka qenë e obliguar t'i paguaj kërkesën e saj, as që ajo ka mund të jetë e obliguar në atë.”*
59. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit i kishte sqaruar parashtrueses së kërkesës se përse në rrethanat e saj nuk aplikohet Kontrata Kolektive Sektoriale, në mënyrë që ajo të realizojë shpërblimin jubilar.
60. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës kishte arritur 20 (njëzetë) vite përvojë të punës më 1 gusht 2013, ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale, të cilës i referohet parashtruesja e kërkesës si bazë ligjore për realizmin e shpërblimit jubilar, kishte hyrë në fuqi më 11 qershor 2018, duke mos prodhuar efekte ligjore në kohën se nuk ishte në fuqi.
61. Gjykata vëren se Kontrata Kolektive Sektoriale e 11 qershorit 2018, nuk kishte qenë e aplikueshme në kohën kur parashtruesja e kërkesës i kishte plotësuar kriteret për realizmin e shpërblimit jubilar.
62. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron si të pabazuara pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me përfundimin e gabuar të Gjykatës së Apelit përkitazi me aplikueshmërinë e Kontratës Kolektive Sektoriale të 11 qershorit 2018 në rastin e parashtrueses së kërkesës, kjo sepse Gjykata e Apelit

e cila është kompetente për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike konstaton se parashtruesja e kërkesës kishte mbushur 20 vite përvojë pune në vitin 2013, në kohën kur Kontrata Kolektive Sektoriale e 11 qershorit 2018 nuk kishte ekzistuar si bazë ligjore për realizmin e shpërblimit jubilar.

63. Gjithashtu, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në kontekst të pretendimit të saj për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i aplikueshmërisë së njëjtë të dispozitave ligjore për raste të njëjta dhe vendosje të ndryshme në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, ka dorëzuar në Gjykatë Aktgjykimin [C. nr. 517/2019] e 17 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit, për të cilin pretendon se rasti i saj ngërthen çështje të njëjta ligjore me ato të rastit të vendosur përmes Aktgjykimit të kontestuar [CA. nr. 5753/2019] të 30 shtatorit 2020 të Gjykatës së Apelit.
64. Në këtë kontekst, Gjykata duhet gjithashtu të rithekson se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër, në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore, si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin Gjykatës, argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin KI35/18, parashtrues "*Bayerische Rechtsverband*", të cituar më lart, paragrafi 76).
65. Gjykata vëren se Aktgjykimi [Ac. nr. 1902/2020] i Gjykatës së Apelit, i 5 nëntorit 2020, i dorëzuar nga parashtruesja e kërkesës në mbështetje të pretendimeve të saj për vendosje të ndryshme në raste të njëjta nga ana e Gjykatës së Apelit, ngërthehen rrethana të ndryshme faktike në krahasim me rastin konkret të parashtrueses së kërkesës, për shkak se parashtruesja e kërkesës në rastin e referuar kishte arritur 30 (tridhjetë) vjet përvojë të punës më 20 maj 2019 ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale si referencë ligjore ishte në fuqi që nga viti 2018.
66. Në dritën e këtyre argumenteve të Gjykatës së Apelit, Gjykata konstaton se të gjitha argumentet e parashtrueses së kërkesës, të cilat ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit të saj, janë parashtruar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI128/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 majit 2019; KI129/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019; KI130/18, parashtrues i kërkesës, *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019).

67. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës, i obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të parashtrueses së kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmërinë e parastresave të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Prandaj, pyetja nëse gjykata ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.
68. Në dritën e trajtimeve të mësipërme, Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28).
69. Gjykata dëshiron të ritheksojë se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejtë i ligjit është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012; rasti KI122/18, parashtruesi i kërkesës *Limak Kosovo International Airport J. S. C. “Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2019, paragrafi 56).
70. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e parashtrueses së kërkesës nuk është shkelur nga vendimet e autoriteteve publike.
71. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e vendimeve të Gjykatës së Apelit nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
72. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë, gjegjësisht me nenet 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

73. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 15 shkurt 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Grësa Caka-Nimani